



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA – MUNICIPALITY OF  
HANI I ELEZIT



Nr:08/10804/23  
Data:29.12.2023

**RAPORTI NGA PROCESI I HARTIMIT TË STRATEGJISË PËR  
ZHVILLIM EKONOMIK 2024-2028 HANI I ELEZIT**

Dhjetor, 2023

## Iyrje

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal është një dokument që prezanton përcaktimin e synimeve, qëllimet strategjike, sfidave që përballon vendi, objektivat e së ardhmes, buxhetin dhe proceset e vlerësimit të projekteve, duke zhvilluar një vizion afatgjatë të Komunës së Hanit të Elezit të përmbledhur në një dokument të vetëm.

## Ecuria e procesit

Procesi i hartimit të dokumentit strategjik filloi si propozim nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm në Komunën e Hanit të Elezit. Pas këtij propozimi është marrë vendimi për themelimin e grupit punues duke përfshirë të gjitha grupet e interesit në të. Gjithashtu Drejtoria ka angazhuar edhe konsulent të jashtëm për të kontribuar në të.

Pas kësaj procedure është mbajtur punëtorja e parë, takim në të cilin u diskutua rëndësia e këtij dokumenti, shqyrtimi i materialeve paraprake dhe përgatitja e draftit.

Pas punëtorisë, Drejtoria ka përpunuar materialin dhe i ka harmonizuar ndërmjet vete ato duke marrë informata nga fusha e sektorë të ndryshëm. Janë mbajtur takime të ndryshme edhe me akter me rëndësi dhe me ndikim në zhvillim.

Gjithashtu janë organizuar edhe dy punëtori të tjera me grupin punues dhe është finalizuar si draft i parë për tu prezantuar para asamblesë komunale në mbledhjen e Komitetit për Politik dhe Financa e më pas edhe në Kuvendin Komunal për muajin shtator. Në po të njëjtën mbledhje asambleja komunale kërkoi plotësim vendim të grupi punues për dokumentin në fjale. U prezantua përfaqësuesit e asamblesë që do të merrnin pjesë në procesin e hartimit.

Gjate mbledhjes së muajit tetor u prezantua drafti i parë i dokumentit dhe metodologjia e punës se si ka rrjedhë procesi e më pas asambleja dha pëlqimin që ky dokument të përcillet për shqyrtim publik. Strategjia për Zhvillim Ekonomik 2024-2028 Hani i Elezit qëndroi në shqyrtim publik nga 01.11.2023 deri më datë 01.12.2023 ndërsa Debatë Publik u organizua më datë 06.12.2023 përpara qytetarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna. Pas Debatit, u finalizua dokumenti duke marrë mendimet dhe vlerësimet nga i gjithë grupi punues.

Pas këtyre procedurave administrative, materiali u plotësua i gjithi dhe u prezantua para Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit Komunal të muajit dhjetor nga ku edhe u miratua si dokument strategjik për periudhën 2024-2028 për planifikim të nivelit lokal.

Data e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime
1. Takim ndërmjet drejtorive dhe stafit komunal	Data: 21.11.2022 Kohëzgjatja: 1 orë	10 persona	Propozimi u dha nga DZHET
2. Takimi I me grupin punues	13.01.2023 Kohëzgjatja: 4 orë	16 persona	Grupi Punues
3. Takimi II me grupin punues	13.09.2023 Kohëzgjatja: 4 orë	15 persona	Grupi Punues
4. Punëtorja III	11.10.2023 Kohëzgjatja: 2 orë	17 persona	Grupi Punues
5. Shqyrtimi Publik	01.11.2023 – 01.12.2023 Kohëzgjatja: 1 muaj	/	Kërkesa të qytetarëve: 0 Kërkesa nga Grupi Punues: 0
6. Debatimi Publik	06.12.2023 Kohëzgjatja: 30 minuta	14 persona	/

Të gjitha kërkesat janë shqyrtuar nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm dhe më pas materiali është finalizuar për tu dorëzuar ne Kuvendin Komunal në dhjetor 2023 nga ku edhe u miratua.

Temat e dëgjimit	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin të komenteve është i detyrueshëm)
Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik 2024-2028	Të bazohen objektivat e sektorit të mjedisit në Planin e Cilësisë së Ajrit	Nexhmedin Daci	E pranuar	Përgjigja: Të gjitha objektivat janë të bazuara në planet paraprake komunale dhe në harmoni të plotë me to.
Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik 2024-2028	Është mirë të parashihet hartimi i Planit për Banim Social	Kimete Kuka-Hasallari	E pranuar	Do të shtohet në pikën e objektivave të drejtorisë në fjalë.

29.12.2023  
Hani i Elezit

Majlinda Valoshi  
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm

